**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr.2 Prot. Tepelenë, më 27.02.2024

**PROÇES – VERBAL**

**(I zbardhur nga origjinali)**

I mbajtur sot, më datë 27.02.2024, ora 10:00 në Pallatin e Kulturës Tepelenë (kati I dytë) eeshtee zhvilluar mbledhja e radhës së Këshillit Bashkiak Tepelenë thirrur nga Kryetari i Këshillit në bazë të Neni 53, pika 3, gërma a, Pika 4 e Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, si dhe "Rregullores së funksionimit të Këshillit Bashkiak"me këtë rend dite:

- Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
- Për miratimin e proçesverbalit të mbledhjes së kaluar, datë 31.01.2024.
- **Projektvendim:** "Për miratimin e ndihmës ekonomike me fond 6% të fondit të kushtëzuar për muajin Janar 2024".
- **Projektvendim:** "Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të Bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin Janar 2024".
- **Projektvendim:** "Për miratimin e raportit vjetor të zbatimit të buxhetit për vitin 2023".
- **Projektvendim:** "Për mbështetje financiare të familjeve në nevojë".
- **Projektvendim:** "Deklaratë për bashkëfinancim të projektit banesa sociale me qera (Përshtatje e katit të dytë të ish maternitetit)".
- **Projektvendim:** "Për trajtim me bonus strehimi të disa familjeve në nevojë të cilat nuk mund ta përballojnë qiranë në tregun e lirë".
- **Projektvendim:** "Për miratim, kërkese për shprehje interesi për shitjen e një apartamenti në qytetin e Tepelenës e cila është në pronësi të degës rajonale Gjirokastër të EKB-së".
- **Projektvendim:** "Për miratimin në parim të nisjes së procedurave për vendparkimet dhe sinjalistika rrugore në qytetin Tepelenë".

1. **Projektvendim:** "Për miratimin e nisjes së procedurave nga Bashkia Tepelenë për zhvillimin e pasurive nr. 24/83, 24/88, 24/90, 24/24/95, 24/110, 24/117, 24/19, 24/120, Zona Kadastrale nr. 3574 në pronësi shtetërore, përdorimin administruar nga Bashkia Tepelenë".

- **Projektvendim**: "Për miratimin në parim të rrugës së kalimit servitut publik, ndodhur në fshatin Luzat, Njësia Administrative Qëndër, ZK 2541 sipas planvendosjes".

2. **Projektvendim**:"Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin Nr.15 datë.27.02.2020, të Këshillit Bashkiak Tepelenë, "Për miratimin e Rregullores së Brendshme" të Këshillit të Bashkisë Tepelenë.

- **Projektvendim**: "Për ngritjen e komisioneve të përhershëm të Këshillit Bashkiak Tepelenë, sipas rregullores së brendshme të Këshillit bashkiak Tepelenë"
- Raporti i performancës së Këshillit Bashkiak Tepelenë për vitin 2023.
- Çështje të tjera.

Kryetar i Këshillit Bashkiak Z. Arben Gumeni drejton mbledhjen.

Ora e hapjes së mbledhjes 10:40

Këshilltarë pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes:

- Latif Kaçaj
- Mirela Varfi
- Mjaftoni Zeraj
- Matilda Çela
- Vladimir Bakiaj
- Esmeralda Bishani
- Ilir Haska
- Besnik Mece
- Vladimir Gjonca
- Ditar Hodaj
- Dino Selimi
- Arben Gumeni
- Marsela Balili
-

Marrin pjesë nga Administrata e Bashkisë:

- Julinda Karteri
- Gëzim Shehu
- Spiro Kora
- Rovena Mullara
- Festime Elezi
- Muin Muca
- Arta Shaha

**Kryetar i Këshillit Z. Arben Gumeni deklaron hapjen e mbledhjes, paraqet rendin e ditës.**

**Kryetari i Këshillit deklaron hapjen e votimit për miratimin e rendit të ditës.**

***Vota PRO***: 14

Latif Kacaj, Mirela Varfi, Mjaftoni Zeraj, Matilda Çela, Vladimir Bakiaj, Vladimir Gjonca, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Ditar Hodaj, Miftar Meta, Arben Gumeni, Dino Selimi, Besnik Maca. Marsela Balili.

***Vota KUNDËR***: S'ka

***Vota ABSTENIM***: S'ka

- **Pika e dytë e rendit të ditës:** "Miratimin e proçesverbalit të mbledhjeve të kaluara datë 31.01.2024"

Kryetari i Këshillit u drejton pyetje këshilltarëve, në lidhje me proçesverbalin e mbledhjes së kaluar.

Këshilltarët shprehin dakortësinë peer përmbajtjen e proçesverbalit.

Kryetari i Këshillit deklaron hapjen e votimit për miratimin e proçesverbalit të mbledhjes së kaluar.

Votimi i hapur

***Vota PRO*** :14

Latif Kacaj, Mirela Varfi, Mjaftoni Zeraj, Matilda Çela, Vladimir Bakiaj, Vladimir Gjonca, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Ditar Hodaj, Marsela Balili, Arben Gumeni, Dino Selimi, Besnik Maca.

***Vota KUNDËR***: S'ka

***Vota ABSTENIM***: S'ka

- **Pika e tretë e rendit të ditës**: "Për miratimin e ndihmës ekonomike me fond 6% të fondit të kushtëzuar për muajin Janar 2024"

Kryetari i Këshillit deklaron shqyrtimin e projektvendimit.

Fjalën e mori Znj. Matilda Çela Kryetare Komisionit Ekonomisë: - Komisioni u mblodh u njoh me materialin dhe vendosi miratimin e ndihmës ekonomike me fond 6% për muajin Janar 2024.

Fjalën e mori Z. Miftar Meta; Një familje në Kurvelesh nuk e ka marrë pagësën e 6 %, mund ta marë për dy,muaj?

Fjalën e mori Z. Spiro Kora Drejtori Zhvillimit Ekonomik; Po është miratuar me vendim të këshillit do ta marë pagesën.

Fjalën e mori Z. Vladimir Bakiaj:- Në listën e qytetit Tepelenë ka pasur me shumë familje, pse janë hequr apo për efekt fondesh?

Fjalën e mori Z. Julinda Karteri: Këto familje nuk kanë dalë përfituese nga skema dhe përfitojnë këtë 6% fondet e Bshkisë është tjetër gjë, skema është korrekte dhe pikëzimi beehet sipas VKM, nuk ka mos trasparencë.

Fjalën e mori Z. Vladimir Bakiaj: Në mbledhjen e rradhës te paraqitet punonjësi i zyrës përkatësë.

Kryetari i Këshillit deklaron hapjen e votimit për miratimin e këtij projektakti.

-Votimi i hapur

***Vota PRO***: 14

Latif Kacaj, Mirela Varfi, Mjaftoni Zeraj, Matilda Cela, Vladimir Bakiaj, Vladimir Gjonca, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Ditar Hodaj, Miftar Meta, Arben Gumeni, Dino Selimi, Besnik Maca, Marsela Balili.

***Vota KUNDËR***: S'ka

***Vota ABSTENIM***: S'ka

- **Pika e katërt Projektvendim:** "Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të Bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin Janar 2024"

Kryetari i Këshillit deklaron shqyrtimin e projektvendimit.

Fjalën e mori Znj. Matilda Çela Kryetare Komisionit Ekonomisë: - Komisioni u mblodh, u njoh me materialin dhe vendosi miratimin e ndihmës ekonomike me fondin e bashkisë, për muajin Janar 2024.

Fjalën e mori Këshilltari, Ditar Hodaj: - Në listat e personave qe trajtohen me ndihmës ekonomike të vendoset atësia.

Kryetari i Këshillit deklaron hapjen e votimit për miratimin e këtij projektakti.

-Votimi i hapur

***Vota PRO:*** 14

Latif Kacaj, Mirela Varfi, Mjaftoni Zeraj, Matilda Cela, Vladimir Bakiaj, Vladimir Gjonca, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Ditar Hodaj, Miftar Meta, Dino Selimi, Arben Gumeni, Besnik Maca, Marsela Balili.

***Vota KUNDËR***: S'ka

***Vota ABSTENIM***: S'ka

- **Pika e pestë e rendit të ditës**: "Për miratimin e raportit vjetor të zbatimit të buxhetit për vitin 2023"

Fjalën e mori Z. Spiro Kora paraqet materialin (bashkëlidhur)

Buxheti social ka qënë një pjesë e rëndësishme e veprimtarisee financiare për zbatimin e buxhetit për vitin 2023

Kryetari i Këshillit: Ka pyetje

Fjalën e mori Z. Ditar Hodaj: - Të falenderoj për materialin, kisha një pyetje tek p/vendimi pse duhet ta miratojmë ne këtë raport pikat a, b, c, cfarë ndodh po nuk e miratuam ne?

Fjalën e mori Z. Spiro Kora: - Në ligjin për financat e vetëqeverisjes vendore neni 51 thotë:

Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes paraqet pranë këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore jo më vonë se data 31 Maj e vitit pasardhës buxhetor, raportin për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit vjetor të vitit paraardhës të njësisë së vetëqeverisjes vendore, për cdo njësi shpenzuese

Raporti vjetor i konsoliduar i zbatimit te buxheit vendor duhet të jetë i krahasueshëm me planin e buxhetit vjetor

Raporti vjetor i konsoliduar i zbatimit te buxhetit vendor përfshin por nuk kufizohet në:

a. Raportin e performancës vjetore të njësisë së vetëqeverisjes vendore e cila bazohet në raportin e monitorimit vjetor të buxhetit

b. Pasqyrat financiare vjetore të njësisë së vetëqeverisjes vendore dokumentacionin bazë dhe atë shoqërues sipas përcaktimit në nenin 40 të këtij ligji

c. Raportin e auditimit të jashtëm,

Fjalën e mori Z. Ditar Hodaj: - Ne se kemi këtë rapor të auditimit si mund ta votoj unë.

Fjalën e mori Z. Spiro Kora: Raporti kur ka ardhur është paraqitur në Këshillin Bashkiak.

Fjalën e mori Z. Ditar Hodaj: - Aktualisht e miratoj unë, unë nuk e kam këtë raport.

Fjalën e mori Z. Spiro Kora: - Ju nuk miratoni këtë raport, miratoni pjësë të raportit

Fjalën e mori Z. Ditar Hodaj: - Mos realizimi i të ardhurave pse nuk mblidhen taksat cila është arsyeja?

Fjalën e mori Z. Spiro Kora: - Sektori përkatës i ka ndjekur të gjitha hapat për vjeljen e detyrimeve, poblematika ka të bëjë më lëvizjen demografike të njerzve, nuk janë gjendur në momentin e lidhjes së kontratës. Për sa u përket subjekteve problematik në rregistra figuron aktiv verifikimi në terren janë mbyllur. Ne kemi menduar rreth mujit Qershor të paraqesim një raport të hollësishëm për situatën e mbledhjes së të ardhurave në Bashkinë Tepelenë ku të bëjmë prezent problematikat dhe vendimarrjet që mund të marë keeshilli brenda kuadrit ligjor,

Fjalën e mori Z. Ditar Hodaj: - Në varrezat e Dëshmorëve të Kurveleshit të ndërhyhet në restaurimin e tyre.

Fjalën e mori Z. Spiro Kora: - Pjesë e rëndësishme po negociohet për një ndërhyrje në kuadrin e 80 vjetorit të clirimit.

Fjalën e mori Z. Dino Selimi: - Ka projekt për varrezat e dëshmorëve në fshatin Progonat

Fjalën e mori Z. Spiro Kora: - Po ka projekt.

Kryetari i Këshillit: Ka pyetje? Jo

Kryetari i Këshillit deklaron hapjen e votimit për miratimin e ketij projektakti.

-Votimi i hapur

***Vota PRO:*** 14

Latif Kacaj, Mirela Varfi, Mjaftoni Zeraj, Matilda Cela, Vladimir Bakiaj, Vladimir Gjonca, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Ditar Hodaj, Miftar Meta, Dino Selimi, Arben Gumeni, Besnik Maca, Marsela Balili.

***Vota KUNDËR***: S'ka

***Vota ABSTENIM***: S'ka

- **Pika e gjashtë e rendit te ditës**: "Për mbështetje financiare të familjeve në nevojë"

Fjalën e mori Z. Spiro Kora:- Ky p/vendim është pjesë e e zbatimit të buxhetit të vitit 2024. Një pikë e rëndësishmë që ju keni miratuar është autorizimi i Kryetarit të Bashkisë për të pëdrorur fondin për trasfertët e individëvë për familjet në nëvojë dhe në situata të vështira Pranë zyrave tona janë paraqitur një sërë kërkesash të qytetarëvë për hallë të ndryshme. Për të bërë më trasparente dhe për të qenë sa më afër komunitetit ne p/vendimin e kemi paraqitur në komisionin përkatës me dokumantaconin bashkëngjitur për trajtimin financiar të një pjese sepse kërkesat janë të shumta. Brenda fondit të miratuar kemi menduar ti trajtojmë këto familje që kanë pasur problematika të rënda për tu ardhur në ndihmë sa më parë, nuk ka ndryshime në buxhet.

Kryetari i Këshillit: Ka pyetje?

Fjalën e mori Z. Ditar Hodaj: - Tek personat për riparim catie, të dy personat janë trajtuar me shumën 2000 mijë lëkë njëri me sip 82m2, tjetri 59m2, të shikohet si është vepruar,

Fjalën e mori Z. Spiro Kora:- Mbështeja jo për të përmbushur të gjithë dëmin ose të gjithë riparimin e banesës, është vendosur një vlerë e përafërt, pasi zyrat përkatësë kanë paraqitur dokumentacionin burimin e të ardhurave në familje, nuk është e thënë që kjo vlerë e përcaktuar të mbuloj gjithë shpenzimin. Mundësit tona finaciare janë sipas shumës së paraqitur në material.

Fjalën e mori Z. Ditar Hodaj: - Spiro të falenderoj për materialin

Kryetari i Këshillit deklaron hapjen e votimit për miratimin e ketij projektvendimi.

-Votimi i hapur

***Vota PRO:*** 14

Latif Kacaj, Mirela Varfi, Mjaftoni Zeraj, Matilda Cela, Vladimir Bakiaj, Vladimir Gjonca, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Ditar Hodaj, Miftar Meta, Dino Selimi, Arben Gumeni, Besnik Maca, Marsela Balili.

***Vota KUNDËR***: S'ka

***Vota ABSTENIM***: S'ka

- **Pika e shtat e rendit të ditës**: "Deklaratë për bashkëfinancim të projektit banesa sociale me qera (Përshtatje e katit të dytë të ish maternitetit)"

Fjalën e mori Z. Ditar Hodaj: - Këtë pikë e vendosëm për të kaluar në komision në mbledhjen ë mëparshme e kaluat në komision?

Fjalën e mori Znj. Matilda Çela Kryetare Komisionit Ekonomi Finance: - Në komision unë kam votuar kundër, dy anëtarët e tjerë e miratuan, do ta diskutojmë këtu përsëri. Na është sjell një deklaratë për bashkëfinancim për projektin, banesa sociale me qera (Përshtatje e katit të dytë të ish maternitetit).

Kati i dytë i tretë sahtë konvikt ku banojnë student kam disa pyetje:

1. Cfarë emërtimi do marrë godina konvikt apo banesa sociale?
2. A është bërë studim për kërkesat për konvikt dhe kërkesat që kanë ardhur për banesa sociale.
3. A është në inventarin e Bashkisë godina ish materniteti?
4. A ka mundësi buxheti i bashkise të bashkëfinancoj 10% të masës së investimit, pasi ne kemi mirauar buxhetin e vitit 2024?

5. Mund të qëndrojnë konviktorët në një godinë ku ku do përshtatet konvikt dhe banesa sociale dhe a do jetë e njëjta hyrje?

Në muajin Dhjetor kemi miratuar bursat për nxënës të arsimit parauniversitar ku kemi dhënë bursa 5 nxënës për shkollat profesionale, 14 bursa për nxënës të rregjistruar në konvikt, 26 nxënës të rregjistruar në konvikt ku 15 marrin shërbim akomodimi në konvikt dhe pjesa tjetër trajtohen me gjysëm burse për shkak se nuk kemi mjedise ku ata të qëndrojnë,

Të vendosin dhe këshilltarët kush është interesi primar i konviktorëve të mos largohen nga Tepelena, që vijnë nga zonat rurale apo interesi i disa banorëve që kërkojne banesa sociale. Projekti të vazhdoj ka ambjete të tjera, jam kundër që projekti të jetë në të njëjtin vend më konviktorët.

Fjalën e mori Drejtore Arsim Sportit Kujdesit Shoqëror Znj. Arta Shaha: - Për pjesën e pronësisë është pronë e Bashkisë Tepelenë është në inventarin e pronave të Bashkisë i cili a kaluar meVKB Nr. 26 datë 29.03.2019.

Po flasim për godinën me tre kate. Kati përdhe quhet kati përdhe, e kemi kthyer në qendër emergjencash për shërbimë komunitare, kati i parë është konvikti i Bashkisë Tepelenë ku kemi strehuar nxënësit që ndjekin gjimnazin e Tepelenës, dhe kati i dytë është bosh, për katin e tretë po flasim ta bëjmë banesa sociale me qera. Numri i aplikantëvë që janë në Bashkinë Tepelenë, kërkesa për strehim është 72 familje, 52 prej të cilave trajtohen me bonus qiraje dhe pjesa tjetër është e pa trajtuar nga Bashkia. Për pjesën e buxhetit ky është kalim në parim, Eshtë e drejta juaj për ta miratuar.

Kryetari i Këshillit: Ka mundësi Bashkia ta financoj 10 %

Fjalën e mori Znj. Matilda Çela Kryetare Komisionit Ekonomi Finance: Spiro pyetja për buxhetin është për ju, po nuk është diskutuar nuk mund të diskutohet tani,

Fjalën e mori Z.Spiro Kora: - Për sa u përket ndryshimeve në buxhet cdo ndryshim paraqitet në këshill, mundësitë financiare kur janë në shërbim të një projekti që i shërben komunitetit gjënden duke shfrytëzuar rezerva tona të brendshme, duke bërë ndryshime brenda të njëjtit program buxhetor ose midis programeve të ndryshme buxhetore, nuk them se është pengesë buxheti për realizimin e projekteve të tilla me karakter social. Është një shpenzim që mbetet dhe i shërben komunitetit, përsa i përket buxhetit në momentin që do miratohet ky projekt do gjenden burimet financire për bashkëfinancim për pjesën që i takon Bashkisë, ashtu sic u gjendën për rikostruksionin e shkollës 9- vjecare "Avni Rustemi" dhe sic do gjenden dhe për projekte të tjera,

Fjalën e mori Znj. Matilda Çela Kryetare Komisionit Ekonomi Finance: - Disa përgjigje i mora disa jo, katet do jenë të emërtuara një kat konvikt një kat banesa sociale. A është e mundur në konvikt të jëtojnë dhe student dhe familjar, si do emërtohet?

Fjalën e mori Z. Ditar Hodaj: - Nuk është arsye emri unë kam jetuar në konvikt me familje,

Fjalen e mori Z. Dino Selimi: - Kati i dytë është konvikt, ka mundësi të ndahet kati i dytë dhe i tretë më shkallë të jashtme, të shikohet kjo mundësi,

Fjalën e mori Z. Spiro Kora: - Ne kemi insistuar tek ky projekt sepse godina po amortizohet, ne nuk e kemi mundësinë për ta rikostruktuar ta shfrytëzojmë këtë mundësi.

Kryetari i Këshillit: Ka pyetje,

Fjalën e mori Znj. Matilda Çela Kryetare Komisionit Ekonomi Finances: - Ju kemi 70 kërkesa, 70 do cohen në banesa sociale. Ne kemi konviktor të pa akomoduar bëjeni projektin diku tjetër, bëjeni aty projektin të jetojnë konviktor në katë të dytë dhë të tretë.

Fjalën e mori Z. Vladimir Bakiaj: - I kemi kërkuar Bashkisë listën me objektet në dispozicion, ka objekte te tjera?

Kryetari I Keshillit: - Sot po diskutojmë për bashkëfinancim në këtë objekt.

Kush nuk do për këtë projket të shprehet me vote.

Fjalën e mori Znj. Matilda Çela Kryetare Komisionit Ekonomi Finance: - Ne nuk jemi kundër financimit të këtij projekti por të bëhet në vend tjëtër.

Kryetari i Këshillit; Të hidhet në votim ky projektvendim

-Votimi i hapur

***Vota PRO:*** 12

Latif Kacaj, Mirela Varfi, Mjaftoni Zeraj, Vladimir Gjonca, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Ditar Hodaj, Miftar Meta, Dino Selimi, Arben Gumeni, Besnik Maca, Marsela Balili.

***Vota KUNDËR***: 2 vota, Matilda Cela, Vladimir Bakiaj

***Vota ABSTENIM***: S'ka

- **Pika e tetë e rendit të ditës:** "Për trajtim me bonus strehimi të disa familjeve në nevojë të cilat nuk mund ta përballojnë qiranë në tregun e lirë"

Fjalën e mori specialisti i sektorit të emergjencave civile Z. Muin Muca: - Paraqet materialin (bashkëlidhur)

Fjalën e mori Z. Ditar Hodaj: - Ne jemi njohur me materialin, ka kaluar në komision.

Fjalën e mori Z. Latif Kacaj: - Komisioni e shqyrtoi materialin është dakort të kaloj në këshill për miratim.

Kryetari i Këshillit: Ka pyetje? Jo

-Votimi i hapur

***Vota PRO:*** 14

Latif Kacaj, Mirela Varfi, Mjaftoni Zeraj, Matilda Cela, Vladimir Bakiaj, Vladimir Gjonca, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Ditar Hodaj, Miftar Meta, Dino Selimi, Arben Gumeni, Besnik Maca, Marsela Balili.

***Vota KUNDËR***: S'ka

***Vota ABSTENIM***: S'ka

- **Pika e nëntë e rendit të ditës:** "Për miratim, kërkese për shprehje interesi për shitjen e një apartamenti në qytetin e Tepelenës e cila është në pronësi të degës rajonale Gjirokastër të EKB-së".

Fjalën e mori Z. Ditar Hodaj: -Ështe bërë njoftimi

Fjalën e mori Drejtore Ligjore Znj. Julinda Karteri: - Kërkesa juaj në mbledhjen e datës 31.01.2024, korekte është bërë njoftimi që atë ditë

Kryetari i Këshillit: Ka pyetje? Jo

-Votimi i hapur

***Vota PRO:*** 14

Latif Kacaj, Mirela Varfi, Mjaftoni Zeraj, Matilda Cela, Vladimir Bakiaj, Vladimir Gjonca, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Ditar Hodaj, Miftar Meta, Dino Selimi, Arben Gumeni, Besnik Maca, Marsela Balili.

***Vota KUNDËR***: S'ka

***Vota ABSTENIM***: S'ka

- **Pika e dhjetë e rendit të ditës: "**Për miratimin në parim të nisjes së procedurave për vendparkimet dhe sinjalistika rrugore në qytetin Tepelenë"

Fjalën e mori Drejtore Ligjore Znj. Julinda Karteri: Për shkak të diskutimeve në mbledhjen e kaluar dhe shqetsimit të drejtë të këshilltarëve dhe të qytetarëvë në Bashkinë Tepelenë si edhe bizneseve ne vendosëm të nisim procedurat për vendparkimet mbështetur në ligjin për vetëqeverisjen vendore në kodin rrugor të Repeublikës së Shqipërisë VKB, për paketën fiskale, për të filluar procedurën në parim të këtyre dy problemeve shumë të rëndësishme sa i përket qarkullimit në qytetin e Tepelenës. Të gjitha projekt vendimet që do shqyrtojmë sot, në vazhdimësi do jenë pjesë e dëgjesave publike deri në vendimin final.Ky është miratim në parim, kemi propozim nga Kryetari i Bashkisë për fillimin e procedurës për parkimet dhe sinjalistika rrugore,

Fjalën e mori Z. Ditar Hodaj: - Duam një material më të hollësishëm për këtë projekt.

Fjalën e mori Drejtore Ligjore Znj. Julinda Karteri: Referenca ligjore është mbështeja në dëgjesat publike që do fillojmë me qytetarët, grupet e interesit, me drejtorine rajonale dhe, komisariatin e policisë, dhe administrata e Bashkisë Tepelenë

Fjalën e mori Z. Ditar Hodaj: Cila pjesë do përfshihet vetëm rruga poshtë?

Fjalën e mori Drejtore Ligjore Znj. Julinda Karteri: Kemi gjithë qytetin vendparkimet dhe sinjalistikla rrugore ato që kemi mirë do ti lëm sic janë do ti qëndrojm fort të gjithë procedurës cdo cështje të kaloj në dëgjesë publike, me të gjitha palët e interesit që janë komuniteti, bizneset, administrata, këshilli bashkiak, dhe të marim një vendim sa më të drejtë. Ne sot miratojme nisjen e procedurës

Fjalën e mori Z. Ditar Hodaj: Ne duam një informacion cfarë do bëhet për se ta votojmë?

Fjalën e mori Drejtore Ligjore Znj. Julinda Karteri: Për fillim procedure kjo procedurë do të përfshi materialin që do të bëj administrata e Bashkisë

Fjalën e mori Z. Ditar Hodaj: Ju keni një projekt ma sill në këshill për miratim.

Kryetari i Keshillit: Do kalohet në parim

Fjalën e mori Z. Ditar Hodaj: Ju si administrat dilni në të gjithë qytetin shkoni në polici dhe ma sillni materialin.

Fjalën e mori Drejtore Ligjore Znj. Julinda Karteri: Do fillojme procesin me dëgjesa publike

Fjalën e mori Z. Ditar Hodaj: E ka ligji për të zhvilluar dëgjesat publike.

Fjalën e mori Z. Vladimir Bakiaj: - Ne do shkojmë në dëgjesë publike duam një projekt

Fjalën e mori Drejtore Ligjore Znj. Julinda Karteri: Ne do vim në këshill për vendimmarrje, ne po fillojmë procedurën për vendparkimet dhe hapat pastaj si administrata dhe këshilli bashkiak janë hapa proceduriale, nuk do jetë vendimarrje pa bërë dëgjesa publike me materaialin që do përgatisi

administrata e bashkisë së bashku me grupet e interesit, projekti do bëhet fizikisht do kaloj në dëgjesë publike pastaj do kaloj për vendimarrje,

Kryetari i Këshillit: Ka pyetje? Jo

Hidhet ne votim 2 vota kundër Ditar Hodaj, Vladimir Bakiaj, abstenim 1 votë, Esmeralda Bishani

-Votimi i hapur

***Vota PRO:*** 11

Latif Kacaj, Mirela Varfi, Mjaftoni Zeraj, Matilda Cela, Vladimir Gjonca, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Ditar Hodaj, Miftar Meta, Dino Selimi, Arben Gumeni

***Vota KUNDËR***: 2 vota

***Vota ABSTENIM***: 1 votë

- **Pika e njëmbëdhjetë e rendit të ditës:** "Për miratimin e nisjes së procedurave nga Bashkia Tepelenë për zhvillimin e pasurive nr. 24/83, 24/88, 24/90, 24/24/95, 24/110, 24/117, 24/19, 24/120, Zona Kadastrale nr. 3574 në pronësi shtetërore, përdorimin administruar nga Bashkia Tepelenë"

Kryetari i Keshillit Z. Arben Gumeni;- Ku është kjo zonë, përvec zone kadastrale të ketë dhe emërtim.

Fjalën e mori Drejtore Ligjore Znj. Julinda Karteri: Zona industriale tek thertorja është miratuar me VKB Nr. 23 datë 31.03.2022

Kryetari i Keshillit Z. Arben Gumeni; - Ka konflik me pronarët?

Fjalën e mori Drejtore Ligjore Znj. Julinda Karteri: Bashkia Tepelenë ka bërë një studim në lidhje me zhvillimin e kësaj pasurie, është pjesë e planit të përgjithshëm vëndor nuk ka konflikt. Pronarët kanë vetëm objektet në pronësi trualli pronë shtetrore e Bashkisë Tepelenë. Zhvilluesi në vitin 2019 ka bërë zhvillimin e kësaj pasurie ka përmbushur të gjitha marrëveshjët kontraktuale me qira nënshkruar me Bashkinë Tepelenë ka shprehur interes sepse Bashkia Tepelene ka bërë njoftim në funksion të planit të përgjithshëm vendor për të pritur të gjitha shprehjet e interesit për zhvillimin e mëtejshëm të kësaj zone sepse është zonë që duhet të zhvillohet. Kemi një shprehje interesi për zhvillimin e mëtejshëm që është subjekti zhvillues e cila e ka shtrirë planin e biznesit për situatat të paparashikuara, zhvillimin e mëtejshëm të objektit është implementuar në planin e përgjithshëm vendor nga ekspertët konsulent, implementimi i të cilit ka mëse tre vjët i publikuar në faqe zyrtare të Bashkisë Tepelenë dhe të AKPT-së.

Në referencë të legjislacionit të sipërpërmendur dhe në referencë të dokumentave të paraqitur është vlërësuar Thertoren Rajonale se një përfitim i lartë publik me vende të shumta pune, nxitje të blegtorisë, të ardhura të konsiderushme për Bashkinë nga aktiviteti i objektit.

Për këte arsye propozohet të miratohet nga Keshilli Bashkiak nisja e procedurave nga administrata e Bashkisë Tepelenë për zhvillimin e kësaj zone me vijimin e procesit për kalimin e pasurisë nga ststusi juridik në përdorim të Bashksë Tepelenë, në statusin juridik në pronësi të Bashkisë Tepelenë,

Kryetari i Keshillit Z. Arben Gumeni: Kjo pronë do jepet me qera?

Fjalën e mori Drejtore Ligjore Znj. Julinda Karteri: Kjo pronë do zhvillohet dhe do ti kalojë pjesës së diskutimit dëgjesës publike sepse ne sot jemi në hapat e fundit për miratimin e planit të përgjithshëm vendor, do kemi një dëgjesë të miratuar nga Agjensia Kombetare e Planifikimit për vlerësimin strategjik mjedisor, do organizohet nga Bashkia Tepelenë më pjesëmarrjen e tyre do bëhet dëgjesë publike dhe për miratimin e këtyre pasurive cdo gjë do kaloj nëpërmjet dëgjesës publike.

Fjalen e mori Z. Vladimir Bakiaj: Jam dakort kjo zonë të zhvillohet por dokumentacioni të paraqitet më i plotë me hartë me studim nuk jam i qartë cfarë do miratoj

Fjalën e mori Z. Ditar Hodaj: Cfarë do zhvillohet në atë zonë?

Fjalën e mori Drejtore Ligjore Znj. Julinda Karteri: Kjo zonë zhvillimi thertore rajonale, ka një plan biznesi,do kaloj me dëgjesë publike.

Kryetari I Keshillit Z. Arben Gumeni: Ka pyetje, ta kalojmë për votim?

-Votimi i hapur

***Vota PRO:*** 14

Latif Kacaj, Mirela Varfi, Mjaftoni Zeraj, Matilda Cela, Vladimir Bakiaj, Vladimir Gjonca, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Ditar Hodaj, Miftar Meta, Dino Selimi, Arben Gumeni, Besnik Maca, Marsela Balili

***Vota KUNDËR***: S'ka

***Vota ABSTENIM***: S'ka

- **Pika e dymbëdhjetë e rendit të ditës:** "Për miratimin në parim të rrugës së kalimit servitut publik, ndodhur në fshatin Luzat, Njësia Administrative Qëndër, ZK 2541 sipas planvendosjes"

Fjalën e mori Drejtore Ligjore Znj. Julinda Karteri: Kjo pikë kërkesa e stabilimenti të ujit të ftoht kemi bërë të gjitha përpjekjet kemi gjetu një rrugë pronë e Bashkisë Tepelenë, e cila është sa më afër kërkesave të stabilimenti, jemi ulur me ta dhe sot jemi me këtë projketvendim sipas planvendosjes

Kryetari I Keshillit Z. Arben Gumeni: Ka pyetje, ta kalojme për votim?

-Votimi i hapur

***Vota PRO:*** 14

Latif Kacaj, Mirela Varfi, Mjaftoni Zeraj, Matilda Cela, Vladimir Bakiaj, Vladimir Gjonca, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Ditar Hodaj, Miftar Meta, Dino Selimi, Arben Gumeni

***Vota KUNDËR***: S'ka

***Vota ABSTENIM***: S'ka

- **Pika e trembëdhjetë e rendit të ditës:** Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin Nr.15 datë.27.02.2020, të Këshillit Bashkiak Tepelenë, "Për miratimin e Rregullores së Brendshme" të Këshillit të Bashkisë Tepelenë
- 

Kryetari I Këshillit Z. Arben Gumeni: Në rregulloren e brendshme të funksionimit të këshillit bashkiak kemi shtuar një komision, për të cilin ne zhvilluam dhe dëgjesën publike në të cilën ju morët pjesë, jeni të qartë për këtë ndryshim në rregullore është shtuar një komision komisioni i integrimit europin dhe mardhënieve me jashtë.

Kryetari i Këshillit: Ka pyetje? Jo

-Votimi i hapur

***Vota PRO:*** 14

Latif Kacaj, Mirela Varfi, Mjaftoni Zeraj, Matilda Cela, Vladimir Bakiaj, Vladimir Gjonca, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Ditar Hodaj, Miftar Meta, Dino Selimi, Arben Gumeni, Besnik Maca, Marsela Balili

***Vota KUNDËR***: S'ka

***Vota ABSTENIM***: S'ka

- **Pika e katërmbëdhjetë e rendit të ditës:** "Për ngritjen e komisioneve të përhershme të Këshillit të Bashkisë Tepelenë, sipas rregullores së brendshme të këshillit Bashkiak Tepelenë"

Kryetari I Keshillit Z.Arben Gumeni: Të shfuqizojmë vendimin e Këshillit bashkiak nr.60 datë 29.06.2023.

Ta hedhim në votim

-Votimi i hapur

***Vota PRO:*** 14

Latif Kacaj, Mirela Varfi, Mjaftoni Zeraj, Matilda Cela, Vladimir Bakiaj, Vladimir Gjonca, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Ditar Hodaj, Miftar Meta, Dino Selimi, Arben Gumeni, Besnik Maca, Marsela Balili

***Vota KUNDËR***: S'ka

***Vota ABSTENIM***: S'ka

Kryetari I Këshillit Z. Arben Gumeni: Propozimet për anëtar komisioni tek komisioni integrimit europian;

Matilda Çela - Kryetare

Vladimr Bakiaj - N/Kryetare

Ilir Haska - Anërar

Hidhet në votim miratohet 14 vota pro

Për miratimin e komisioneve si më poshtë

Tek komisioni i barazisë gjinore heqim Matildën, vendosim

Mirela Varfi - Kryetare

Marsela Balili - N/kryetare

Marjo Jorgo - Anëtar

Hidhet në votim miratohet 14 vota pro.

Komisioni i Shëndetsisë si më poshtë:

Ilir Haska - Kryetar

Esmeralda Bishani - N/Kryetare

Ditar Hodaj - Anëtar

Hidhet në votim miratohet 14 vota pro.

Komision i arsim-kulturës si më poshtë:

Mirala Varfi - Kryetare.

Besnik Maca - N/Kryetar

Vladimir Bakiaj - Anëtar

Kryetari i Këshillit Z.Arben Gumeni: Ka pyetje, ta kalojmë për votim?

-Votimi i hapur

***Vota PRO:*** 14

Latif Kacaj, Mirela Varfi, Mjaftoni Zeraj, Matilda Cela, Vladimir Bakiaj, Vladimir Gjonca, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Ditar Hodaj, Miftar Meta, Dino Selimi, Arben Gumeni, Besnik Maca, Marsela Balili

***Vota KUNDËR***: S'ka

***Vota ABSTENIM***: S'ka

**Raporti i performancës së Këshillit Bashkiak Tepelenë për vitin 2023.**

Fjalën e mori Z. Ditar Hodaj: Jemi njohur me materialin jemi dakort.

- **Cështje të tjera**

Kryetari I Këshillit Z.Arben Gumeni: Këhillit Bashkiak Tepelenë i është drejtuar ankesë nga Z. Petrit Pila. (Bashkëlidhur ankesa – lexuar)

Fjalën e mori Z. Dino Selimi: Gjendja civile e Z. Petrit Pila, në Tepelenë por ka jetuar në fshat, ne si këshill kemi marre dy vendime një pro, një kundër.

Fjalën e mori Z. Vladimir Bakiaj: Ankesa nuk ka vërejtje kur u bë procedura për zgjedhjen së kyetarit të fshatit ne si komision nuk e dinim këtë gjë.

Fjalën e mori Z. Ditar Hodaj: Ka dal problem gjëndja civile nuk e ka në fshat, nderkohë që ka toka, banesë në fshat, si e ka ligji të presim dhe pergjigjen e portalit ndoshta jep mendim. Ne kemi propozuar të jepet vula tek personi i dytë ose Kryetari I Bashkisë të delegoj një person derisa të bëhen zgjedhjet në fshat. Z.Petrit Pila po e ka cuar gjendjen civile në fshat të bëhen zgjedhje përsëri.

Fjalën e mori Drejtore Ligjore Znj. Julinda Karteri: Brenda rregullores është i cituar neni 50 - Kriteret e kandidatit për anëtarë të kryesisë:

- Të jetë banor I rregjistruar I lagjes/ fshatit në të cilën kërkon të zgjidhet të paktën prej 10 vitesh. Procesi I zgjedhjes dhe veprimtaria e kryesisë së fshatit mbikëqyren nga Këshilli Bashkiak, po shpjegoj rregulloren

Kryetari I Këshillit Z. Arben Gumeni: Përkufizimi i rregullores thotë që mund të zgjidhet kryetar fshati dhe një mësues, infermier, I cili punon në fshat por gjendjen civile e ka në Tepelenë por banon atje. Unë propozoj të shqyrtohen në komision të dyja këto ankesa dhe të merret vendimi për procedurën. (Ankesa e Z. Fatmir Çela në mbledhjen e datës 31.01.2024 është shqyrtuar dhe është vendosur të përsëriten zgjedhjet)

Kryetari i Këshillit Z. Arben Gumei: Ta hedhim në votim këtë propozim

-Votimi i hapur

***Vota PRO:*** 13

Latif Kacaj, Mirela Varfi, Mjaftoni Zeraj, Matilda Cela, Vladimir Bakiaj, Vladimir Gjonca, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Miftar Meta, Dino Selimi, Arben Gumeni, Besnik Maca, Marsela Balili

***Vota KUNDËR***: 1 votë Ditar Hodaj

***Vota ABSTENIM***: S'ka

Kërkesë nga Z. Flori Elezaj Njësia Adm Lopës (bashkëlidhur kërkesa)

Kryetari i Këshillit: Këto kërkesa të shkojnë në bashki ti delegohet zyrës përkatëse

Mbyllet mbledhja e këshillit bashkiak ora 12:12

**SEKRETARE E KËSHILLIT**
**Valbona ÇELA**

**KRYETAR I KËSHILLIT**
**Arben GUMENI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA TEPELENË